

Çfarë mendon ti? **EVER**  
Çka mund të bësh?  
ndryshosh ti?

Kuvendi President  
Shteti

Kushtetuta  
AMENDAMENTI

Çfarë do të thotë kjo?

Kush i shkruan ligjet?

VOTA

IME

ARDHMËRIA

IME!



osce Organization for Security and  
Co-operation in Europe  
Mission to Serbia



OSCE Organization for Security and  
Co-operation in Europe  
Mission to Serbia

Kuvendi

presidenti

Qeveria



VOTA IME - ARDHMËRIA IME

Programin "Vota ime - Ardhmëria ime" e realizon Kuvendi Popullor i Republikës së Serbisë në bashkëpunim me Qeverinë e Republikës së Serbisë dhe me Sekretariatit e përgjithshëm të presidentit të Republikës, dhe këtë me përkrahjen e Misionit të OSBE-së në Serbi. Publikimi "Vota ime - Ardhmëria ime" është pjesë e programit në fjalë.

Vërejtje: Qëndrimet e shprehura në këtë publikim u takojnë vetëm autorëve dhe nuk i shprehin domosdoshmërisht edhe qëndrimet e Misionit të OSBE-së në Serbi.

# VOTA IME - ARDHMËRIA IME



**P**olitika? Pse do të duhej të më interesoj?

A ke menduar ndonjëherë si do të duket shteti yt për dhjetë ose pesëmbëdhjetë vjet dhe ti ku do ta kesh vendin?

A do të jetosh në shtetin i cili do të respektojë të të drejtat e njeriut, i cili do të luftojë kundër mjedisin jetësor, i cili do të luftojë kundër varfërisë .... ? Në shtetin në të cilin meshkujt dhe gratë janë të barabartë? Në shtetin i cili do të të mundësojë që lirisht të udhëtosh dhe ta njohësh botën?

A ke menduar se si pikërisht ti mund të ndikosh në të gjitha këto?

Të gjitha këto pyetje kanë ndikim ndaj teje dhe ndaj njerëzve të cilët i njeh, dhe të gjitha këto në njëfarë mënyre kanë lidhje me politikën.

Prandaj do të duhej të të interesojë.

**Çfarë mendon ti?**

Çfarë ti mendon, cilat janë çështjet vendimtare sot?

A brengosesh se si do të gjeshë punën të cilën e dëshiron? Çfarë po ndodh me ndryshimet klimatike dhe me ngrohjen globale? Shëndetësinë, arsimin?

E sheh se, politika është pjesë edhe e jetës sate të përditshme edhe e njerëzve për të cilët ti je e interesuar. Lajm i mirë është që ti mund të ndikosh që gjërat të shkojnë për mirë.

Çfarë mund të ndryshosh ti?

Pikëpamja jote për botën është unike dhe njësoj e rëndësishme sikur e secilit njeriu tjetër. Bota në të cilën jetojmë po ndryshon shpejt dhe nuk ke kohë të jesh vetëm vëzhgues i pafjalë. Duke e fituar të drejtën e votës, do të fitosh edhe pushtetin të ndikosh dhe të ndryshosh.

Merr pjesë dhe formoje ardhmërinë tënde.

**Si funksionojnë gjërat?**

Secili shtet demokratik bazohet në mbizotërimin dhe respektimin e ligjit. Prej kësaj varet edhe ardhmëria jote. Që të mund të ndikosh, duhet të dish në çfarë mënyre në shtetin tënd miratohen ligjet dhe kush e bën këtë.

Ekzistojnë tri institucione vendimtare në rrugën e ligjit. Qeveria, zakonisht është propozuesja e ligjeve. Kuvendi Popullor, i cili e shqyrton propozimin e ligjit dhe e miraton ligjin dhe Presidenti i Republikës, i cili e miraton dekretin për shpalljen e ligjit.

Në faqet e ardhshme do të mësosh pak më shumë për secilin nga institucionet e theksuara..

Në fillim, mbaje mend, çdo gjë fillon nga vota jote. Por, si?



# QEVERIA E REPUBLIKËS SË SERBISË

Qeveria e Republikës së Serbisë është organi më i lartë i pushtetit ekzekutiv në Republikën e Serbisë.

## Çfarë do të thotë kjo?

Kjo domethënë se Qeveria e

- Përcakton dhe e udhëheq politikën e Republikës së Serbisë në kuadër të Kushtetutës dhe të ligjit dhe të akteve tjera të përgjithshme të Kuvendit Popullor
- Në kuadër të kompetencave të veta, i miraton urdhëresat dhe aktet tjera të përgjithshme për ekzekutimin e ligjeve

I propozon Kuvendit Popullor ligjet edhe aktet tjera të përgjithshme, përkatësisht e jep mendimin kur i propozon propozuesit tjetër

- Orienton dhe e harmonizon punën e organeve shtetërore të administratës dhe e kryen mbikëqyrjen ndaj punës së tyre



Qeveria në kuadër të kompetencave të veta është e pavarur. Për politikën e Republikës së Serbisë dhe ekzekutimin e ligjeve dhe të akteve tjera të përgjithshme, Qeveria i jep përgjegjësi Kuvendit Popullor.

Qeverinë e përbëjnë kryeministri, një ose më shumë nënkryetar dhe ministrat.

Si mund të bëhet dikush kryeministër i Qeverisë, e si ministër?

Kandidatin për kryeministër të Qeverisë, Kuvendit Popullor ia propozon presidenti i Republikës pasi që e dëgjon mendimin e përfaqësuesve të zgjedhur nga listat e zgjedhëseve, pas përfundimit të zgjedhjeve (në të cilat edhe ti vendos!). Kandidati për kryeministër të Qeverisë ia paraqet programin e Qeverisë Kuvendit Popullor („ekspozeu i kryeministrit“) dhe e propozon përbërjen e Qeverisë (i propozon ministrat), e pas kësaj Kuvendi Popullor voton për programin dhe zgjedhjen e kryeministrit dhe të anëtarëve të Qeverisë, përkatësisht ministrave.



Ndërtesa e Qeverisë së Serbisë është ngritur midis vitit 1926 dhe 1928. Fillimisht ka qenë ndërtesë e Ministrisë së Financave e Mbretërisë së Jugosllavisë. Ndërtesa është vepër e arkitektit Nikolaj Krasnov dhe paraqet përmendoren e rëndësishme të kulturës ndërtimore te ne.

# QEVERIA E REPUBLIKËS SË SERBISË



Kryeministri i Qeverisë kujdeset për unitetin e veprimit politik të Qeverisë, e harmonizon punën e anëtarëve të qeverisë, e përfaqëson qeverinë, e fton dhe i udhëheq seancat e saj.

## Ja edhe disa fakte për Qeverinë ...

Mandati i Qeverisë zgjat derisa të skadojë mandati i Kuvendit Popullor i cili e ka zgjedhur, por që Kushtetuta e përcakton kur i pushon mandati Qeverisë edhe para skadimit të kohës për të cilën është zgjedhur.

Qeveria i miraton vendimet në seancë me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të Qeverisë. Mënyrën e punës dhe të vendimmarrjes së Qeverisë dhe aktet të cilat i miraton kryeministri i Qeverisë më hollësisht rregullohen me Rregulloren e Qeverisë.

Për aplikimin e Rregullores kujdeset Sekretari i përgjithshëm i Qeverisë.

Organe të administratës shtetërore, në pajtim me Rregulloren e Qeverisë, konsiderohen ministrinë, veçanërisht organizatat dhe shërbimet e Qeverisë.

Qeveria me vendim themelon ndërmarrje publike, institucione dhe organizata tjera publike, ndërmerr masa dhe i rregullon çështjet me rëndësi të veçantë dhe vendos për gjërat tjera për të cilat me ligj ose me dekret është caktuar që Qeveria t'i rregullojë me vendim.

Qeveria në veprimin e vet i kryen edhe punët e tjera të caktuara me Kushtetutë dhe me ligj.

Dhe, gjë që është shumë e rëndësishme, puna e Qeverisë është publike.



**Nëse dëshiron të mësosh më shumë për Qeverinë,**  
**Mund të vizitosh [www.srbija.gov.rs](http://www.srbija.gov.rs)**

Pasi që ke mësuar pak më shumë për institucionet të cilat marrin pjesë në procesin legjislativ, ja si udhëton propozimi i ligjit derisa përfundimisht të hyjë në fuqi. Do të shohësh se fjala është për procedurë të ndërlikuar dhe rreptësisht të kontrolluar, sepse kjo është e domosdoshme, duke e marrë parasysh se ligji aprovar kur hyn në fuqi ndikon në jetët e të gjithë neve.

# KUVENDI POPULLOR I REPUBLIKËS SË SERBIË

## Çfarë bën Kuvendi?

Kuvendi Popullor i miraton ligjet. Përveç kësaj ai është institucioni i vetëm i autorizuar i cili e miraton dhe e ndryshon Kushtetutën. Kuvendi Popullor ka edhe rol mbikëqyrës. Ai e kontrollon se si Qeveria i zbaton ligjet dhe aktet tjera të përgjithshme të Kuvendit Popullor. Përveç kësaj, Kuvendi Popullor e zgjedh dhe e shkarkon Qeverinë, i shpall referendumet, i konfirmon kontratat ndërkombëtare, vendos për luftën dhe paqen ... Prandaj, Kuvendi Popullor është organi më i rëndësishëm i shtetit.

## Kush janë deputetët e popullit?

Kuvendi Popullor është vend ku punojnë përfaqësuesit legjitimë, të zgjedhur të popullit - deputetët e popullit.

Të drejtë të zgjedhin deputetët e popullit ose të kandidohen që të zgjedhen si deputetë të popullit, kanë të gjithë shtetasit e Republikës së Serbisë të cilët i kanë mbushur 18 vjet.

Qytetarët në zgjedhjet e



fsheht a dhe të drejtpërdrejta i zgjedhin deputetët e popullit. Edhe ti kur t'i mbushësh 18 vjet do të fitosh këtë të drejtë.

Pasi të mbarojnë zgjedhjet, të drejtë të marrin pjesë në ndarjen e mandateve kanë vetëm ato lista të zgjedhëse të cilat i kanë fituar më së paku pesë përqind të numrit të përgjithshëm të votave të zgjedhëse të cilët kanë votuar. Për partitë të cilat i grumbullojnë pakicat kombëtare vlejnë rregullat e posaçme. Përveç kësaj, në secilën listë të zgjedhëse duhet të jenë më së paku 30 përqind të grave.



Ndërtesa e Kuvendit Popullor është ndërtuar në periudhën prej vitit 1907 deri 1936. Projekti ideor është vepër e arkitektit Jovan Ilkijiq, kurse objektin e ka përfunduar rusi Nikolaj Krasnov. Ndërtesa e Kuvendit Popullor është një nga shembujt më të bukur të arkitekturës neoklasiciste te ne.

# KUVENDI POPULLOR I REPUBLIKËS SË SERBISË



## Si duket jeta e Kuvendit?

Në pauza të seancave në korridore të Kuvendit Popullor është atmosfera mjaft dinamike, mund të shihen deputetët e popullit, gazetarët dhe punonjësit në shërbimet e Kuvendit. Seancat, zakonisht mbahen prej prej orës 10 në mëngjes deri në orën 18 të pasdites. Në pauza deputetët e popullit i mbajnë konferencat për gazetarë, i kanë mbledhjet e grupeve të deputetëve, seancat e këshillave, qëndrojnë në bibliotekë ose në Qendër për hulumtime.

Nëse dëshiron të mësosh më shumë për Kuvendin Popullor, mund të vizitosh adresën [www.parlament.rs](http://www.parlament.rs)

Në këtë mënyrë mund të marrësh edhe materialin e domosdoshëm që në shkollën tënde, me shokët dhe profesorët e tu, të simulosh tërë seancën e Kuvendit Popullor dhe praktikisht të mësosh se si miratohen ligjet.

Nga momenti kur e fillojnë detyrën, deputetët e popullit e kanë përgjegjësinë ndaj partisë e cila i ka kandiduar, por edhe ndaj qytetarëve të cilët i kanë zgjedhur.

## Si mund të bëhesh ti deputet i popullit?

I vetmi kusht i nevojshëm që të kandidohesh në zgjedhje për deputetë të popullit është të jesh shtetas i Republikës së Serbisë dhe të kesh mbushur 18 vjet. Mund të kandidohesh në ndonjë parti politike me të cilën i ndan qëndrimet ose para grupit të qytetarëve, nëse grumbullon mjaft në nëshkrime për kandidaturë, e që nevojiten 10 000.



Nëse ti dhe shokët e tu dëshironi të vizitoni Kuvendin Popullor, bisedoni me deputetët e popullit ose të përcillni seancën e Kuvendit, mund të telefononi në numrin e tel. 011 3026 100 ose me email në [r.dinic@parlament.rs](mailto:r.dinic@parlament.rs)

# PRESIDENTI I REPUBLIKËS

## Si zgjedhet Presidenti?

Për president të Republikës së Serbisë mund të kandidohet secili shtetas i Serbisë i moshës madhore dhe i aftë për punë të cilin me nënshkrimet e veta e mbështesin 10 000 votues.

Zgjedhjet për president të ri të Republikës i shpall kryetari i Kuvendit Popullor 90 ditë para skadimit

të mandatit të presidentit aktual të Republikës, kështu që zgjedhjet përfundojnë gjatë 60 ditëve të ardhshme, në pajtim me ligjin.

Mandati i presidentit të Republikës zgjat 5 vjet dhe fillon të rrjedhë nga data e dhënies së betimit para Kuvendit Popullor.

Ja edhe teksti i betimit të cilin presidenti i Republikës e jep:




*„Betoem se me tërë forcën time do t'i përkushtohem ruajtjes së sovranitetit dhe të tërësisë territoriale të Republikës së Serbisë, duke përfshirë edhe Kosovën dhe Rrafshin e Dukagjinit si pjesë e saj përbërëse, si edhe realizimin e të drejtave dhe të lirive të njeriut dhe të pakicave, respektimin në mbrojtjen e Kushtetutës dhe të ligjit, ruajtjen e paqes dhe të mirëqenies së të gjithë qytetarëve të Republikës së Serbisë dhe që me ndërgjegje dhe me përgjegjësi do të plotësojë të gjitha detyrat e mia“*

Sikur ti të ishe president/e, ja se çfarë do të të duhej krejt të bësh:

- Të përfaqësosh Republikën e Serbisë në vend dhe në botën e jashtme
- Të emërosh dhe të shkarkosh me dekret ambasadorët e Republikës së Serbisë në bazë të propozimit të Qeverisë
- Të marrësh letra akreditimi dhe revokimi të përfaqësuesve të huaj diplomatikë
- Të komandosh Ushtrinë e Serbisë
- Të propozosh Kuvendit Popullor kryeministrin e Qeverisë, pasiqë e dëgjon mendimin e përfaqësuesve të zgjedhur nga lista e zgjedhëseve
- T'i propozosh Kuvendit Popullor bartësit e funksioneve, në pajtim me Kushtetutën dhe me ligjin
- Me dekret të shpallësh ligjet, në pajtim me Kushtetutën
- Të bësh amnistimet dhe dekorimet

... edhe shumë, shumë prej këtyre.



Presidenti i Republikës punon në ndërtesën e Pallatit të Ri. Pallatin e Ri e ka projektuar Stojan Titelbah, dhe është ndërtuar prej vitit 1911 deri 1922. Ndërtesa është shembull reprezentativ i arkitekturës akademike të ne. Mjaft ka pësuar dëme gjatë të dy luftërave për çka edhe sot e ka pamjen dukshëm të ndryshuar.



Pra, siç e sheh, kjo është punë me mjaft  
kërkesa dhe përgjegjësi!  
Nëse dëshiron të mësosh më shumë për  
presidentin e shtetit vizitoje adresën

[www.predsednik.rs](http://www.predsednik.rs)

## Çka duhet të dish më tepër...

**P**ara se gjithash, ç'do të  
thotë ligj dhe pse  
miratohen ligjet?

Ligji është akt i përgjithshëm  
normativ i shtetit me të cilin  
rregullohen marrëdhëniet  
shoqërore të cilat krijohen në  
të gjitha fushat e jetës.

**Kush i harton ligjet?**

Zligjet i hartojnë juristët,  
profesorët e së drejtave,  
ekspertët e fushave të  
ndryshme, punëtorët  
shkencorë dhe të tjerët të  
cilët mund të ndikojnë që  
propozimi i ligjit të jetë sa më  
i mirë

**Kush mund të propozojë ligjet?**

Ekzistojnë 6 propozues të autorizuar të ligjit, dhe  
këtë

- Qeveria e Republikës së Serbisë
- Secili deputet i popullit
- Kuvendi i krahinës autonome
- Mbrojtësi i qytetarëve (nga kompetenca e vet)
- Banka Popullore (nga kompetenca e vet) dhe
- Më së paku 30 000 zgjedhës (nisma e qytetarëve)

Në praktikë, zakonisht propozuesi më i shpeshtë i ligjeve është  
Qeveria e Republikës së Serbisë, d.m.th, ministrët e saj

**Kuht i dërgohet propozimi i ligjit?**

Qeveria e Republikës së Serbisë (ose ndonjë propozues tjetër i  
autorizuar) tekstin e propozimit të ligjit ia dërgon Kuvendit Popullor.  
Kryetari i Kuvendit Popullor, menjëherë pas pranimit, tekstin e  
propozimit të ligjit ua dërgon të gjithë deputetëve të popullit dhe



# Çka duhet të dish më tepër...

## Ç'janë këshillat e Kuvendit Popullor?

Këshillat janë organe të punës së Kuvendit Popullor të cilat formohen për punën më efikase. Anëtarët e këshillave janë deputetët e popullit dhe secili këshill e ka kompetencën e vet (psh., Këshilli për bujqësi, Këshilli për shëndetësi, Këshilli legjislativ, Këshilli për financa etj.). Këshillat e shqyrtojnë propozimin e ligjit nga kompetenca e vet dhe e japin mendimin.

## Çfarë ndodh me propozimin e ligjit?

Pastaj propozimi i ligjit vihet në rend të ditës së seancës së Kuvendit Popullor, për t'u shqyrtuar dhe përmirësuar me amendamente, para votimit për aprovimin e tij.

## Çfarë janë amendamentet?

Amendamentet janë propozimet për plotësim ose ndryshim të propozimit të ligjit i cili është në rend të ditës. Propozues të amendamenteve mund të jenë të gjithë

deputetët e popullit, këshillat e kuvendit, por edhe Mbrojtësi i qytetarëve dhe Banka Popullore. Propozues i amendamenteve mund të jetë edhe Qeveria, pa e marrë parasysh a e ka

propozuar ligjin ose jo pikërisht ajo.

Amendamentet paraqiten që teksti i propozimit të ligjit të jetë sa më i mirë.

Nëse propozuesi i ligjit dhe këshilli kompetent e pranojnë amendamentin, ai bëhet pjesë përbërëse e propozimit të ligjit.

## Ç'është „shqyrtimi në parim“ i propozimit të ligjit?

Kur deputetët e popullit vendosin a ka fare nevojë për aprovimin e ligjit të propozuar ose konsiderojnë se kjo fushë e jetës shoqërore tashmë mjaft është rregulluar ligjësisht – ky quhet shqyrtim në parim

## Ç'është „shqyrtimi në hollësiira“ i propozimit të ligjit?

Shqyrtimi në hollësiira e cilëson shqyrtimin për secilin nen të propozimit të ligjit dhe këtë për secilin nga amendamentet e paraqitur.





## Ç'është „Dita për votim“?

Kuvendi Popullor vendos për propozimet e ligjit në parim, hollësitat dhe në tërësi, në Ditën për votim. Vetëm kur propozimi i ligjit të pranohet në parim, Kuvendi Popullor fillon vendim-marrjen për amendamentet. Në fund - deputetët votojnë për propozimin e ligjit në tërësi.

Sa vota „për“ nevojiten për t'u votuar ligji?

Me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të popullit (126, sepse gjithsej janë 250) Kuvendi i Popullit

vendos për ligjet me të cilat rregullohen fushat më të rëndësishme të jetës shoqërore dhe shtetërore. Në rastet tjera mjafton që „për“ të vendosë shumica nga deputetët e popullit të pranishëm, me kusht që të jenë të pranishëm më së paku 126.

## Ç'është shpallja e ligjit dhe kush e bën këtë?

Kuvendi i Popullit ligjin e votuar ia dërgon presidentit të Republikës i cili e shpall. Presidenti i Republikës ligjin e shpall me miratimin e dekretit.

Para se që hyn në fuqi ligji i votuar si edhe dekreti me të cilin është shpallur botohen në „Fletoren zyrtare të Republikës së Serbisë“ Ligji zakonisht hyn në fuqi ditën e tetë nga data e shpalljes.

Ja si duket rruga e ligjeve në shtetin tonë. Mirëpo, ekzistojnë edhe shumë hollësiira në këtë procedurë të ndërlikuar. Për shembull, si miratohen ligjet me procedurë urgjente, çfarë ndodh nëse presidenti refuzon të shpallë ligjin për të cilin ka votuar Kuvendi popullor, çfarë ndodh nëse ekziston dyshimi se ligji nuk është në pajtim me Kushtetutën etj?

Nëse dëshiron të mësosh më shumë për të gjitha këto hollësiira, mund të vish në ndonjë nga këto tri institucione dhe aty për aty të marrësh përgjigjet për pyetjet tua.

*Siç e sheh, çdo gjë fillon nga vota jote dhe nga vota jote varet çdo gjë: kush do t'i miratojë ligjet në emrin tënd dhe si do të duken ato ligje.*

*Tërë procesi legjislativ fillon me zgjedhjet, në të cilat ti e jep votën tënde.*

*Që ardhmëria jote të jetë ashtu çfarë e do, duhet të marrësh pjesë.*

**Mos harro:**

**VOTA IME - ARDHMËRIA IME**

VOTA

TIME

ARDHMERTIA

TIME!